



UDHËZUES

PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

**PËR PUNONJËS SOCIALE TË NJËSIVE TË
VLERËSIMIT TË NEVOJAVE DHE REFERIMIT
PRANË NJËSIVE ADMINISTRATIVE**



UDHËZUES

PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

PËR PUNONJËS SOCIALE TË NJËSIVE TË
VLERËSIMIT TË NEVOJAVE DHE REFERIMIT
PRANË NJËSIVE ADMINISTRATIVE

TIRANË, DHJETOR 2023

Ky udhëzues është hartuar nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri në kuadër të projektit "Ofrimi i sigurisë dhe mbrojtjes efektive për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Tiranë", zbatuar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Autor: © Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, Dhjetor 2023

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)

PËRMBAJTJA

1. LISTA E SHKURTIMEVE	6
2. HYRJE	7
3. TË NJOHIM KONTEKSTIN E DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI	9
4. QËLLIMI I UDHËZUESIT	11
5. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL MBI DHUNËN NË FAMILJE	12
5.1. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	12
5.2. LEGJISLACIONI SPECIFIK PËR NJVNR	16
6. VLERËSIMI I NEVOJAVE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE	20
7. FAKTORËT E RISKUT	23
7.1. IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE TË RISKUT	23
7.2. RËNDËSIA E PERCEPTIMIT TË VIKTIMËS PËR RISKUN	25
8. VLERËSIMI I RISKUT	26
9. HARTIMI I PLANIT INDIVIDUAL TË PËRKUJDESIT DHE MBËSHTETJES	28
10. BASHKËRENDIMI I PUNËS ME AKTORË TË TJERË OFRUES TË SHËRBIMEVE	30
11. LITERATURA E PËRDORUR	32

1. LISTA E SHKURTIMEVE

DhF	Dhuna në familje
VDh	Viktima të dhunës
NjVNR	Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
NjA	Njësi Administrative
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit i rasteve të dhunës në familje
KVDhF	Koordinatori Vendor kundër Dhunës në Familje
UMM	Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes
UM	Urdhri i Mbrojtjes
OJF	Organizatë jofitimprurëse
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
WAVE	Rrjeti Kundër Dhunës në Evropë

2. HYRJJE

Punonjësit e njësive administrative kanë një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e dhunës në familje dhe me bazë gjinore, minimizimin e pasojave të saj apo parandalimin e rasteve të femicidit në vend.

Për shkak të ndërveprimit të përditshëm me komunitetin, punonjësit e njësive administrative janë shpesh personat e parë që kanë kontakt me viktimat e dhunës në familje dhe për këtë arsye është e nevojshme të zotërojnë kapacitetet e duhura për të evidentuar treguesit e dhunës në familje, të kryejnë menaxhimin e rasteve dhe t'i referojnë pranë institucioneve përkatëse ofrues të shërbimeve sipas nevojave dhe specifikave të rasteve.

Bazuar në ligjin 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", strukturat që duhet të ngrihen e të funksionojnë në nivel bashkie për asistimin e grupeve në nevojë, janë: a) strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki; b) njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit (NjVNR), të krijuara në nivelin e njësive administrative. Këto të fundit i vijnë në ndihmë të gjithë grupeve vulnerabël në territorin ku operojnë dhe janë posaçërisht të rëndësishme në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje pasi ligjërisht janë struktura zbatuese të politikave sociale lokale e kombëtare duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për individët në nevojë. Edhe pse është detyrim ligjor dhe ligji është miratur prej vitit 2016, NjVNR nuk janë ngritur në çdo bashki. Deri tani, kjo strukturë është ngritur kryesisht në bashkitë e mëdha të vendit dhe kjo ka ndodhur gjatë viteve të fundit. Duke qenë se janë struktura të reja, punonjësit socialë të NjVNR kanë nevojë për udhëzim dhe orientim në punën e tyre me viktimat e dhunës në familje.

Ky dokument është formuluar në mënyrë të tillë që të jetë një ndihmë praktike në punën e NjVNR për të trajtuar në mënyrë efektive rastet e dhunës në familje. Kryerja e punës me efektivitet kërkon domosdoshmërisht njohuri shumë të mira të legjislacionit në fushë pasi çdo veprim në mbrojtje të viktimave duhet të kryhet në përputhje të plotë me parashikimet legjislative. Për këtë arsye, një pjesë shumë e rëndësishme e këtij udhëzuesi i dedikohet parashikimeve ligjore lidhur me dhunën në familje.

Subjekt i dhunës në familje mund të jetë çdo person pavarësisht nga moshë, statusi socio-ekonomik, niveli i arsimimit, gjendja familjare apo martesore dhe padyshim, pavarësisht nga gjinia. Por, nuk mund të mohojmë faktin se gratë janë shumë më tepër të rrezikuara nga dhuna në familje dhe dinamikat e abuzimit janë të ndryshme krahasuar me burrat¹. Studimet në nivel global tregojnë se rreth 90% të subjekteve të dhunës në familje janë gra dhe vajza. Për më tepër, gratë janë më të rrezikuara nga vrasjet midis partnerëve intimë se sa burrat. Për këto arsye, ky udhëzues i referohet kryesisht dhunës në familje të ushtruar nga burrat mbi gratë.

Krahasuar me grupet e tjera vulnerabël që NjVNR asiston, viktimat e dhunës në familje mbartin në vetvete rrezik për shëndetin, sigurinë dhe jetën që mund të shkaktohet nga një person tjetër. Kjo ka bërë që çështje të trajtuara me prioritet në këtë udhëzues të jenë identifikimi i faktorëve të riskut dhe vlerësimi i riskut.

Së fundi, dëshirojmë të theksojmë se “e mbijetuar e dhunës në familje” është një term që përdoret gjerësisht në ditët e sotme kur flitet për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë në familje, por, për të qenë korrekt me terminologjinë e përdorur në legjislacionin shqiptar, në këtë udhëzues përdoret termi “viktimë e dhunës në familje”.

¹ Marianne Hester, “Kush i bën çfarë kujt? Gjinia dhe dhunuesit në familje në të dhënat e policisë angleze”, Gazeta Europiane e Krimnologjisë, vol. 10, Nr. 5, 2013, fq. 623–663.

3. TË NJOHIM KONTEKSTIN E DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI

Shqipëria ka bërë përparim në adresimin e çështjeve gjinore dhe dhunës në familje, kryesisht përmes përmirësimit të kuadrit ligjor dhe përafrimit të tij me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Megjithatë, pabarazitë gjinore, dhuna ndaj grave dhe vajzave, vazhdojnë të jenë shqetësim serioz dhe një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut duke ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave dhe vajzave në shoqëri. Pabarazia gjinore nuk është vetëm një çështje e të drejtave të njeriut, është një humbje e jashtëzakonshme e potencialit njerëzor. Duke u mohuar grave të drejta të barabarta, ne i mohojmë gjysmës së popullsisë mundësinë për të jetuar duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë.

Gratë në Shqipëri përballen me forma të ndryshme të trajtimit të pabarabartë, duke përfshirë diskriminimin gjinor dhe dhunën në familje. Krahas dhunës në familje, forma të tjera veçanërisht të përhapura të dhunës ndaj grave janë: abuzimet seksuale, martesat e detyruara, vrasjet për nder, privimi nga arsimi, mohimi i të drejtave pronësore, mungesa e aksesit në punë dhe shërbime, diskriminimi në punë, pjesëmarrja e pabarabartë në vendimmarrje, etj.

Anketa e Tretë Kombëtare e Bazuar në Popullsinë për Dhunën ndaj Grave e kryer nga Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT) në vitin 2018, tregoi se një në dy (52.9%) gra shqiptare kanë përjetuar një ose më shumë forma të dhunës ndaj grave gjatë jetës së tyre dhe 36.6% e tyre pohuan se aktualisht janë duke përjetuar dhunë. Format më të zakonshme të dhunës janë përjetuar gjatë një lidhjeje dashurie ose në familje dhe ushtrohen nga partneri intim².

Të dhënat e Policisë së Shtetit për vitin 2022, treguan se janë evidentuar dhe trajtuar nga policia gjithsej 5210 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të kryera në marrëdhëniet familjare. Në total, 72% (3767) e rasteve kanë qenë gra dhe vajza. Për 2940 raste të dhunës në familje është hartuar kërkesë padi për urdhër mbrojtje. Bazuar në nenin 130/a të Kodit Penal

² INSTAT, "Gratë dhe burrat në Shqipëri", 2021.

“Dhuna në familje”, ndjekja penale ka filluar për 1887 raste dhe 682 dhunues janë arrestuar. Përqindja më e lartë e grave që i nënshtrohen dhunës në familje (bazuar në numrin e aplikimeve për UM dhe UMM) është përqendruar në qarkun e Tiranës i ndjekur nga Durrësi. Këto të dhëna konfirmojnë dimensionin shqetësues të këtij fenomeni për një vend të vogël siç është Shqipëria.

Vitet e fundit kanë treguar një rritje shqetësuese të rasteve të femicidit në Shqipëri. 37 gra dhe vajza janë vrarë nga partneri, bashkëshorti ose një anëtar tjetër i familjes gjatë 3 viteve të fundit (2021-2023). Në shumicën e rasteve, viktimat e kishin denoncuar dhunën në polici dhe kishin marrë një urdhër mbrojtje nga gjykata. Sistemi i mbrojtjes ka dështuar në ofrimin e sigurisë pasi nuk ka marrë masat e duhura ndaj autorëve të krimit apo për menaxhimin efektiv të rasteve.

Edhe pse të dhënat tregojnë shifra të larta të raportimeve të dhunës në familje, shumica e grave që përjetojnë dhunë nuk kërkojnë asnjëherë ndihmë ose nuk e raportojnë dhunën tek autoritetet. Kjo për shkak edhe të mungesës së besimit që kanë ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, të cilat kanë për detyrë të mbështesin dhe mbrojnë viktimat e dhunës. Bazuar në sondazhin kombëtar “Barometri Shqiptar i Sigurisë” të kryer nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në vitin 2020, 13,6% e popullsisë së anketuar deklaroi se nuk i beson Policisë së Shtetit. Këto përqindje thellohen ndjeshëm kur bëhet fjalë për prokurorinë dhe gjykatën: 43.5% nuk i besojnë punës së prokurorisë dhe besimi në gjykata është akoma më i ulët ku 45.9% e popullsisë deklaroi se nuk ka besim, që është në mënyrë absolute përqindja më e lartë krahasuar me të gjitha institucionet e vëzhguara nga ky sondazh kombëtar.

Nga ana tjetër, shumë gra nuk raportojnë dhunën sepse dhuna ndaj grave tolerohet gjerësisht dhe justifikohet në shoqërinë shqiptare. Shqipëria është një vend me mentalitet patriarkal të theksuar i cili i rezervon gruas një pozitë inferiore në shoqëri. Është e ditur se ka një korelacion midis nivelit të shprehjes së dhunës ndaj grave dhe mentalitetit patriarkal në një shoqëri. Ndodh që mentaliteti patriarkal të prevalojë dhe viktimat të stigmatizohen edhe nga ofruesit e shërbimeve të cilët duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri për to.

Shërbimet e specializuara për viktimat e dhunës në familje janë të limituara dhe të lokalizuara kryesisht në zonat urbane. Shërbimet sociale në zona rurale janë të pakta ose inekzistente. Kjo bën që numri i grave dhe vajzave

të përfshira në programe të mbështetjes të jetë i ulët në krahasim me nevojat. Ndihma ekonomike që viktimat e dhunës me urdhër mbrojtje përfitojnë nga shteti është në masën 9,900 lekë, shumë e cila pavarësisht ase është rritur krahasuar me vite më parë, mbetet jashtëzakonisht e ulët dhe nuk plotëson nevojat bazë për jetesë.

Nisur nga përmasat që ka fenomeni i dhunës në familje është e rëndësishme që ndërhyrjet në mbështetje të viktimave të dhunës të jenë multidimensionale duke përfshirë së pari buxhetimin e shërbimeve për to por edhe duke punuar për parandalimin, minimizimin e pasojave dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve.

4. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij publikimi është t'i vijë në ndihmë punonjësve socialë të njësive administrative, në mënyrë specifike Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, në punën direkte në mbrojtje dhe mbështetje të rasteve të dhunës në familje, të jetë një udhërrëfyes praktik për të menaxhuar në mënyrë efektive rastet.

Menaxhimi i përgjegjshëm, në zbatim të ligjit, shmang vazhdimin e dhunës, rrit besimin e viktimave tek ofruesit e shërbimeve dhe është veçanërisht i rëndësishëm për rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të viktimave të dhunës në shoqëri. Në këtë aspekt, nuk duhet të lihen jashtë vëmendjes edhe fëmijët e viktimave të dhunës. Fokusi i ofruesve të shërbimeve zakonisht shkon tek viktimat, ajo që referon episodet e dhunës, shpesh duke mos marr në konsideratë ose minimizuar dhunën direkte apo indirekte që fëmijët pësojnë. Dy kapituj shumë të rëndësishëm të këtij publikimi i dedikohen vlerësimit të nevojave dhe vlerësimit të riskut të viktimave të dhunës në familje. Në rastin kur ato janë nëna me fëmijë, të dyja vlerësimet patjetër që do të hartohen edhe duke mbajtur në vëmendje *interesin më të lartë të fëmijëve*.

Përmbajtja e udhëzuesit bazohet jo vetëm në legjislacionin shqiptar dhe standarde ndërkombëtare por edhe në raporte ndërkombëtare për zbatimin

e Konventës së Stambollit³, Konventës CEDAW⁴, raportin e Shqyrtimit për Shqipërinë të Komisionit European, etj. Legjislacioni shqiptar mbi dhunën në familje është gati i kompletuar dhe parashikimet ligjore ofrojnë siguri, mbrojtje e mbështetje për viktimat. Nga ana tjetër, realiteti flet për zbatim shumë pak efektiv ose të munguar. Ky udhëzues do të ndihmojë edhe në këtë aspekt sa i përket angazhimit efektiv të punonjësve socialë të njësive administrative në zbatimin e parashikimeve ligjore.

Një nga qëllimet e tjera të udhëzuesit është që të sjellë në vëmendje standardet e cilësisë. Për Shqipërinë, vështirësia kryesore në zbatimin e standardeve të cilësisë qëndron në çështjen e burimeve: standardet me cilësi të lartë të ofruesve të shërbimeve mund të garantohen vetëm nëse sigurohen burime të përshtatshme për zbatimin e tyre. Për të qenë konkretë, burimet për të mbështetur viktimat e dhunës në familje dhe për të ofruar shërbime cilësore për to, janë të limituara. Ato ekzistuese nuk janë të shpërndara në mënyrë proporcionale në të gjithë territorin e vendit. Udhëzuesi do të orientojë audiencën e synuar drejt shfrytëzimit efektiv të burimeve në dispozicion.

5. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL MBI DHUNËN NË FAMILJE

5.1. Një vështrim i përgjithshëm

Konventa e Stambollit është një nga instrumentat më të rëndësishëm në nivel ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes të grave nga të gjitha format e dhunës, parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Shqipëria ka nënshkruar Konventën më 19 dhjetor 2011 dhe e ka ratifikuar më 4 shkurt 2013 duke e bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm dhe të detyrueshme për zbatim.

³ Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, Këshilli i Evropës, 2011.

⁴ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1979.

Konventa e përkufizon dhunën ndaj grave si *"shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private"*.

Në pjesën hyrëse të saj, Konventa shprehet se *"dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e të plotë të grave"*. Prandaj, dhuna ndaj grave nuk është problem individual, nuk ka të bëjë me zgjedhjen e bashkëshortit apo partnerit të gabuar, dhuna ndaj grave ka natyrë strukturore dhe është një nga mekanizmat thelbësorë socialë me anë të të cilave gratë detyrohen të qëndrojnë në pozitë inferiore krahasuar me burrat. Si pasojë, arritja e barazisë de jure dhe de facto midis grave dhe burrave është një element kryesor në parandalimin e dhunës ndaj grave.

Me ratifikimin e Konventës, Shqipëria detyrohet të përafrojë ligjet, politikat me standardet e Konventës dhe të marrë masa të tjera për të zbatuar këtë instrument. Në vijim, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e legjislacionit, hartimin e politikave të reja me qëllim mbrojtjen e grave nga dhuna, por ende mbetet shumë për të bërë. Kjo vërtetohet edhe nga sugjerimet që GREVIO⁵ ka dhënë për Shqipërinë në Raportin e Vlerësimit Bazë në vitin 2017, rekomandimet e Komitetit të Palëve⁶ në Janar 2018 dhe përfundimet e zbatimit të rekomandimeve të dërguara sërish nga Komiteti i Palëve.

Konventa CEDAW është një tjetër instrument shumë i rëndësishëm ndërkombëtar në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave. Me ratifikimin e Konventës, me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993⁷ dhe Protokollit shtesë⁸ të kësaj konvente me ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, shteti shqiptar ka shprehur vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin konventa, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave. Sipas Konventës CEDAW shprehja "diskriminim ndaj grave" nënkupton *"çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi*

⁵ Organ i pavarur monitorues i të drejtave të njeriut i mandatuar për të monitoruar zbatimin e Konventës së Stambollit.

⁶ Organ politik i Konventës së Stambollit.

⁷ Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, "Për aderimin në Konventën 'Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave'".

⁸ Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave".

bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër⁹. Prej momentit që Konventa është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar, Komiteti CEDAW ka kryer disa vlerësime mbi zbatimin e Konventës në Shqipëri duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse. Vlerësimi më i fundit është kryer në Tetor 2023 ku dy nga shqetësimet kryesore të ngritura janë: 1) efektiviteti i limituar i legjislacionit në fushën e barazisë gjinore dhe 2) nevoja për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të ligjeve.

Shqipëria ka qenë një nga vendet e para në rajon që ka nënshkruar Konventën e Stambollit dhe që ka miratuar një ligj specifik për dhunën në familje. Në 18 Dhjetor 2006 u miratua **ligji nr. 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjere"**, ligj i cili ka pësuar ndryshime e përmirësime të herëpashershme për t'iu përgjigjur ndryshimeve të fenomenit të dhunës në familje dhe nevojave reale të viktimave. Një arsye tjetër pse ky ligj ka pësuar ndryshime, është pikërisht nevoja për të përafuar legjislacionin e brendshëm rreth dhunës në familje me Konventën e Stambollit, rekomandimet e Komitetit të Palëve dhe rekomandimet e Komitetit CEDAW.

Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ka për qëllim të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, si dhe të sigurojë më shumë mbrojtje për viktimat. Ndryshimet më të fundit dhe më të rëndësishme që ligji ka pësuar kanë qenë në vitet 2018¹⁰ dhe 2020¹¹.

Ndryshimet në ligjin "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familje" në përputhje me rekomandimet e GREVIOs dhe ato të Komitetit të CEDAW, konsistojnë kryesisht në:

- ✓ harmonizimin e përkufizimit të dhunës në familje me atë në Konventën e Stambollit dhe plotësimin me nocionin e marrëdhënieve intime;

⁹ Neni 1 i Konventës CEDAW.

¹⁰ Ligji nr. 47/2018, datë 23.7.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar

¹¹ Ligji nr. 125, datë 15.10.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

- ✓ zgjerimin e subjekteve që përfitojnë ndihmë si personat me aftësi të kufizuar, fëmijët dëshmitarë, etj;
- ✓ shtimin e garancive ligjore për personat me aftësi të kufizuar, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, në kuadër të hamonizimit të këtij ligji me parashikimet e legjislacionit në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore;
- ✓ zgjerimin e rrethit të subjekteve që përfshihen në kategorinë e pjestarëve të familjes dhe heqjen e kufizimeve kohore duke parashikuar mbrojtje të posaçme edhe për personat që janë në lidhje afektive (intime). Sipas ligjit "marrëdhënie intime" është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional. Ky koncept përfshin marrëdhënien ndërmjet dy personave që i përkasin gjinive të ndryshme ose të personave të të njëjtës gjini;
- ✓ përmirësimin e masave mbrojtëse të parashikuara në ligj, në kuadrin e urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrimit të mbrojtjes, duke pasur parasysh, veçanërisht, përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët;
- ✓ rritjen e sigurisë që jep Policia e Shtetit nëpërmjet Urdhrit për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme;
- ✓ dhënien e ndihmës ligjore falas, nëpërmjet avokatëve të kualifikuar mbështetur në parashikimet e ligjit 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";
- ✓ përcaktimin e afateve të qarta procedurale për regjistrimin e kërkesës për UM-në dhe UMM-në dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore;
- ✓ përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave të organeve përgjegjëse në fushën e masave kundër dhunës në familje;
- ✓ ngritjen e qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;
- ✓ marrjen e përgjegjëseve nga njësitë e qeverisjes vendore për mbikqyrjen, monitorimin e zbatimit të ligjit dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- ✓ rregullimin e mënyrës së referimit të rasteve të dhunës në familje, monitorimi i ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes dhe të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;
- ✓ shtimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara të fokusuara në forma të veçanta të dhunës ndaj grave, siç është dhuna seksuale;
- ✓ rritjen e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, drogë, ose me probleme të shëndetit mendor, si dhe marrja e masave për largimin e dhunuesit nga banesa;

- ✓ shtimi i dispozitave të reja për qasjen e profesionistëve në situata të emergjencës;
- ✓ detyrimin e gjykatës për të vendosur masa mbrojtëse edhe kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim;
- ✓ përfshirja në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, të largimit të menjëhershëm të dhunuesit nga banesa.

Sa i përket **legjislacionit penal**, prej vitit 2012, në Shqipëri, dhuna në familje konsiderohet si vepër penale e parashikuar në nenin 130/a të Kodit Penal, i cili shprehet se: *“rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, plagosja e kryer me dashje, dënohen me burgim (deri në 5 vite heqje lirie për plagosjen me dashje)”*.

Kodi Penal pësoi një amendim shumë të rëndësishëm në këtë fushë, me miratimin e Ligjit nr. 35 datë 16.04.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndryshimi kryesor konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike në marrëdhëniet familjare si dhe përfshirja në këto marrëdhënie të personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, duke harmonizuar përmbajtjen e nenit 130/a të Kodit Penal me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet e vitit 2018 në ligjin për dhunën në familje.

5.2. Legjislacioni specifik për NjVNR

Konventa e Stambollit i dedikon një nen të veçantë vlerësimit të rrezikut ku shprehet se *“Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar”*¹². Rëndësia e këtij neni nënvizohet edhe në nenin 22 të Direktivës së BE për të drejtat e viktimës (Direktiva 2012/29/EU), e cila gjithashtu shprehet për një *“vlerësim individual të viktimave për të identifikuar nevojat specifike për mbrojtje”*¹³.

¹² Neni 51 “Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut”, pika 1.

¹³ Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, përkrahjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

Pra, Konventa e Stambollit përcakton detyrimin për të garantuar se të gjitha autoritetet përkatëse, pa u kufizuar vetëm te policia, vlerësojnë dhe hartojnë në mënyrë efikase një plan për të menaxhuar rreziqet që një viktimë e dhunës has rast pas rasti, në bazë të procedurës së standardizuar dhe në bashkëpunim dhe koordinim me njëra-tjetrën. Padyshim, këtu përfshihet edhe detyrimi i NjVNR për të vlerësuar seriozitetin e situatës dhe të veprojë për menaxhimin e rrezikut për viktimën e dhunës.

Ligji specifik që ngarkon me përgjegjësi e detyrime për mbrojtjen e viktimave të dhunës punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore është **ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"**. Bazuar në këtë ligj, pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë. Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror¹⁴.

Punonjësit socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:

- a) identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë;
- b) vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë;
- c) informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla;
- ç) hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes;
- d) bashkërendimin e mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimin te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm;
- dh) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit;
- e) mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar;

¹⁴ Neni 36, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 121/2016.

- ë) hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016;
- f) aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:

- a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10000 banorë;
- b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë;
- c) administrator shoqëror¹⁵.

Nga sa përshkruhet më sipër, NjVNR-ja i vjen në ndihmë të gjithë grupeve vulnerabël në territorin ku operon për t'i garantuar dhënien e ndihmës dhe respektimin e të drejtave. Një nga grupet që asiston janë edhe viktimat e dhunës në familje. Kryesisht procesi i vlerësimit të nevojave të VDh për shërbime sociale në nivel njësie administrative, është një komponent shumë i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në nivel vendor, i cili mundëson shërbime të orientuara drejt nevojave reale të tyre.

Sa i përket detyrimeve të NjVNR në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, neni 5 përcakton autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe në pikën 2/ë të nenit theksohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore janë një nga autoritetet përgjegjëse.

Në nenin 7, pika 4 e ligjit përcaktohen shprehimisht dhe në mënyrë të detajuar detyrat e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

- a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;
- b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to;
- c) koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

¹⁵ ESA Consulting/UNICEF, “Udhërrëfyes për bashkitë për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, Mars 2019, fq. 10.

- ç) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;
- d) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;
- dh) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;
- e) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Neni 8 i ligjit shprehet për përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse. Në mënyrë të veçantë, pika "dh" e këtij neni i drejtohet punonjësve socialë për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit duke theksuar se ata duhet të përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të hartimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.

Në nenin 23 "Ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor", pika 3 shprehet se *"Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura në përputhje me Nenin 10 të këtij ligji"*. Pika 3/1 thekson *"gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/ UM, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e*

menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm”.

6. VLERËSIMI I NEVOJAVE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Në thelb, vlerësimi i nevojave është një analizë e detajuar e nevojave të plota të individit, qëllimeve që ka dhe rezultateve që dëshiron të arrijë.

Vlerësimi i nevojave të rasteve të dhunës në familje, praktikisht shërben për të krijuar lidhjen midis nevojave të viktimës për ndihmë e mbështetje dhe shërbimeve ekzistuese të cilat ajo mund të përdorë. Nga ana tjetër, shpesh, vlerësimi i nevojave na tregon boshllëqet në ofrimin e shërbimeve dhe mungesës së shërbimeve të përshtatshme për viktimat e dhunës.

Është e rëndësishme që për të vlerësuar nevojat, takimi midis punonjësit të NjVNR dhe viktimës së dhunës të realizohet në një mjedis privat, të qetë dhe me derë të mbyllur, ku askush nuk mund të dëgjojë apo të ndërhyjë në bisedë.

Rekomandohet që biseda të fillojë me pyetje jo të drejtëpërdrejta si për shembull:

- Si ndiheni?
- A është çdo gjë në rregull në shtëpi?
- Keni mbështetje nga familjarët tuaj?

Më pas të vazhdojë mbledhja e të dhënave dhe të parashtrohen pyetje më të drejtëpërdrejta lidhur me përmasat e dhunës, situatën e viktimës, nevojat që ajo ka dhe, sipas rastit, punonjësi i NjVNR të formulojë ide fillestare se çfarë masash duhet të ndërmerren për t'a mbështetur

**Në asnjë mënyrë,
punonjësi i NjVNR nuk
duhet t'i sugjerojë
viktimës që të
largohet nga shtëpia
apo edhe të marrë
vendime me të cilat
ajo nuk pajtohet.**

viktimën e DhF. Vlerësimi i nevojave është një proces që duhet të kryhet në bashkëpunim shumë të ngushtë me viktimën dhe çka është më e rëndësishmja, të respektohet vullneti i lirë i saj edhe pse kjo çështje merr diskutim nisur nga dinamika e DhF.

Në vlerësimin e rastit, punonjësi social duhet ta shohë individin në kontekstin e mjedisit familjar, duke u dhënë përparësi atyre shërbimeve që e mbështesin individin për një jetesë brenda familjes dhe komunitetit ku jeton. Shërbimet rezidenciale, larg familjes, duhet të konsiderohen si alternativa e fundit dhe vetëm kur janë të pashmangshme.

Për të kryer vlerësimin, punonjësit social i duhet që, përveçse të bëjë një intervistë me individin që ka nevojë për shërbime, të vizitojë familjen e tij, apo të komunikojë me persona që janë në dijeni të nevojave të individit. Në përfundim të vlerësimit të kryer, punonjësi social përgatit Planin Individual të Përkujdesit dhe Mbështetjes, duke përfshirë në këtë proces vetë individin që ka nevojë për mbështetje¹⁶.

Është e domosdoshme që të bëhet ndarja midis:

1. vlerësimit të nevojave emergjente;
2. vlerësimit të nevojave afatgjata.

Kjo do të thotë që vlerësimi i nevojave nuk mund të kryhet vetëm një herë, në fillim të menaxhimit të rastit por ky vlerësim ndyshon në bazë të situatës në të cilën viktimja ndodhet (situatë emergjente apo situatë më e stabilizuar në të cilën mund të mendohet për mbështetje afatgjatë).

Punonjësi i NjVNR ngarkohen nga ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për të kryer vetëm vlerësimin fillestar të nevojave por gjatë procesit të menaxhimit dhe monitorimit të rasteve mund të evidentohen nevoja të tjera për të cilat punonjësi duhet të përgjigjet duke ofruar ndihmën ose duke bërë referimin në ofrues të tjerë të shërbimeve (sipas specifikave të rasteve).

¹⁶ ESA Consulting/UNICEF, "Udhërrëfyes për bashkitë për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror", Mars 2019, fq. 36.

Shembull: Laura është 28 vjeçe, nënë e një djali 2 vjeç dhe viktimë e dhunës në familje. Bashkëshorti i saj ka ushtruar shpesh dhunë fizike dhe psikologjike ndaj saj dhe vitin e fundit dhuna është përshkallëzuar. Pas episodit të fundit të dhunës, Laura vendos të kërkojë mbrojtje në polici. Pasi raportoi dhunën dhe në polici u kryen të gjitha procedurat e aplikimit për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes, gjykata vendosi të lëshonte UMM ku, ndër masat e tjera, përcaktoi se dhunuesi duhej të largohej nga banesa. Institucionet përkatëse kryen ekzekutimin e vendimit dhe bashkëshorti i saj u largua nga banesa. Rasti referohet punonjësit social të NjVNR në NjA ku Laura banon dhe, duke respektuar detyrimet që ligji i ngarkon, punonjësi i NjVNR vlerëson nevojat fillestare të viktimës së dhunës. Për Laurën ishte e domosdoshme të ofrohej mbështetje psikologjike pasi ishte e rënduar psikologjikisht. Gjithashtu, mendonte se këshillimet me një psikolog do ta ndihmonin të qetësohej dhe qartësohej se çfarë duhet të bënte në të ardhmen. Ende nuk ishte e bindur nëse duhet të ndërmerre hapin për t'u divorcuar nga bashkëshorti i saj. Gjithmonë kishte ëndërruar për një jetë të lumtur familjare dhe dëshironte që fëmija i saj të rritej me praninë e babait në shtëpi. Bazuar në vlerësimin fillestar të nevojave, punonjësi i NjVNR referon rastin për këshillim dhe asistencë psikologjike falas pranë një OJF-je që operon në zonë. Punonjësi i NjVNR harton edhe planin individual të përkujdesit dhe mbështetjes dhe përgatit dosjen me të gjithë dokumentacionin e rastit. 10 ditë pas lëshimit të UMM, punonjësi i NjVNR kontakton me Laurën për të monitoruar ecurinë e saj. Laura i referon se prej gati 5 ditësh, bashkëshorti i saj e kërcënon vazhdimisht në telefon dhe i ka shkuar disa herë tek vendi i punës dhe në shtëpi. Ai kërkon të ribashkohet por duke e kërcënuar se nëse ajo nuk e lejon të kthehet në shtëpi, do t'i marrë djalin. Laura referon se ditët e fundit është bërë edhe më agresiv se çka qenë më parë. Ndihet tejet e frikësuar dhe nuk di si të veprojë. Tashmë është e bindur se duhet të divorcohet por ka frikë se si ai do reagojë nëse ajo i drejtohet gjykatës.

Nga rasti i mësipërm, është e qartë se edhe pse punonjësi i NjVNR ka kryer vlerësimin fillestar të nevojave dhe ka referuar rastin për shërbime, në momentin që kryen monitorimin, situata ka ndryshuar dhe janë identifikuar nevoja të tjera për mbështetje. Dhuna në marrëdhënie familjare vazhdon

edhe pse çifti nuk jeton më në të njëjtën banesë. Punonjësi i NjVNR duhet të bashkëpunojë me policinë, të referojë se dhunesi ka shkelur UMM dhe policia më pas duhet të procedojë në rrugë penale. Rasti ka gjithashtu nevojë për mbështetje ligjore në mënyrë që të informohet rreth procedurave penale të mëpasshme dhe procedurave për pajisjen me Urdhër Mbrojtje. Gjithshtu, krahas informimit dhe mbështetjes për marrjen e UM, rasti duhet të mbështetet edhe për procesin civil të zgjidhjes së martesës. Për këtë, punonjësi i NjVNR duhet të referojë rastin për përfitim të ndihmës ligjore falas pranë Zyrës Rajonale të Ndihmës Juridike Falas¹⁷ ose një OJF-je që ofron këtë shërbim pa pagesë. Nëse viktimja e dhunës i drejtohet sërish gjykatës dhe pajiset me UM, punonjësi i NjVNR duhet ta asistojë për përfitimin e ndihmës ekonomike nga shteti nën statusin e viktimës së dhunës në familje. Është e qartë se me marrjen djeni të episodeve të fundit të dhunës, monitorimi i rastit duhet të vijojë.

7. FAKTORËT E RISKUT

7.1. IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE TË RISKUT

Identifikimi i faktorëve të riskut është i rëndësishëm:

1. për ofruesit e shërbimeve në mënyrë që të hartojnë dhe zbatojnë në mënyrë efektive planin e ndërhyrjes;
2. për sistemin e drejtësisë në mënyrë që të marrin vendime të drejta dhe masa në përputhje me rrezikshmërinë e situatës;
3. për vetë gratë dhe vajzat viktimja të dhunës në familje në mënyrë që të kuptojnë nivelin e rrezikut për to dhe fëmijët e tyre.

¹⁷ Bazuar në ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

Faktorët e riskut ndryshojnë nga njëri rast në tjetrin. Sjellim në vëmendje trajtimin që i ka bërë WAVE kësaj çështjeje në ndërhyrjen si palë e tretë në gjykimin e çështjes Kurt kundër Austrisë në vitin 2020, përpara GjEDNj.

Faktorët e rrezikut që duhet të identifikohen dhe mbahen në konsideratë nga NjVNR në trajtimin e rasteve, janë:

- dhuna e mëparshme e ushtruar ndaj viktimës;
- rritja e frekuencës dhe ashpërsisë së incidenteve të dhunës;
- kërcënimet për dëmtime dhe ushtrim force;
- kërcënimet me vdekje;
- mbytja, e cila është potencialisht vdekjeprurëse;
- dhuna seksuale dhe përdhunimi;
- përdorimi i armëve ose kërcënimi me armë;
- konsiderimi i viktimës si pronë, xhelozia ekstreme dhe mospranimi i dëshirës së viktimës për t'u divorcuar. *Mospranimi i dëshirës së viktimës për t'u ndarë krijon situata shumë të rrezikshme në kohën kur viktima përpiqet të largohet;*
- varësia e dhunuesit nga substancat, lojërat e fatit dhe stresi ekonomik;
- kërcënimet e dhunuesit për vetëvrasje;
- shkeljet e urdhrave të mbrojtjes. *Ato shoqërohen me një risk në rritje të dhunës në të ardhmen;*
- Veçimi. *Nëse një viktимë vendos të raportojë dhunën në polici dhe të largohet nga dhunuesi i rrezikshëm, risku i lëndimit dhe vrasjes së saj është i lartë dhe një mbrojtje efektive në këtë moment është thelbësore.*

Viktimat e dhunës në familje nuk janë të rrezikuara vetëm nga dhunuesi por, për shkak të gjendjes psikologjike të rënduar të shkakuar nga dhuna, nuk mund të përjashtohet mundësia që të mund të lëndojnë veten apo të tentojnë vetëvrasjen. Për këtë arsye, punonjësi social i NjVNR duhet të marr në konsideratë edhe riskun që ka viktima e dhunës për të dëmtuar veten. Me qëllim parandalimin e dëmtimit të vetes, vëmendje e shtuar duhet të tregohet në identifikimin dhe trajtimin e disa faktorëve individual të riskut, të tilla si:

- gjendje e rënduar psikologjike apo depresion;
- të ardhura të pamjaftueshme për jetesë;
- histori të mëparshme abuzimi;
- izolim nga familja apo miqtë;

- mungesa e mbështetjes nga familja e origjinës;
- përdorimi i alkoolit ose drogës.

7.2. RËNDËSIA E PERCEPTIMIT TË VIKTIMËS PËR RISKUN

Burimi kryesor i ofruesve të shërbimeve për kryerjen e vlerësimit të riskut janë pohimet e viktimës. Padyshim që pohimet përmbajnë perceptimin që vetë viktima ka për riskun që i kanoset. Në shumë raste, viktima është gjyqëtarja më e mirë për nivelin e rrezikut sepse ajo njihet sëlljet e dhunuesit dhe ka një sens intuitive për rrezikun ndaj saj.

Studimet kanë treguar se perceptimi që viktima e dhunës në familje ka për riskun që i kanoset është një parashikim për dhunën në të ardhmen. Nëse perceptimet e viktimës për riskun përfshihen në vlerësimin e riskut të ofruesve të shërbimeve, ky vlerësim do të ishte më efektiv, duke iu përgjigjur kështu nevojave reale të viktimës për mbrojtje dhe siguri. Perceptimi i vetë viktimave për rrezikun me të cilin përballen është i rëndësishëm dhe duhet të merret parasysh nga punonjësit e NjVNR si pikënisje për asistimin e rasteve në vijim.

Për të hartuar një vlerësim risku në përshtatje me situatën, punonjësi i NjVNR duhet ta drejtojë bisedën me viktimën në mënyrë të tillë që të eksplorojë eksperiencën e saj të dhunës dhe nivelin e frikës që ajo ndjen për veten dhe fëmijët e saj. Viktima duhet të jetë në gjendje që të shprehë mendimet e saj në mënyrë spontane dhe pa u ndërprerë kur flet rreth fakteve të situatës së saj.

Është e rëndësishme që gjatë bisedës me viktimën, punonjësi social të fitojë besimin e saj. Krijimi i marrëdhënies së besimit është thelbësor jo vetëm për të vlerësuar riskun por edhe për të menaxhuar me sukses rastin në vijim.

Nga ana tjetër, është gjithashtu e rëndësishme të mbahet në vëmendje se jo të gjitha viktimat janë të sakta në parashikimet e tyre për riskun. Duhet konsideruar fakti se shpesh viktimat e dhunës janë në gjendje të rënduar

psikologjike, zhvillojnë mekanizma mbrojtës të cilat minimizojnë perceptimin për dhunën, mundohen të justifikojnë sjelljet e dhunuesit dhe si pasojë mund të nënvlerësojnë riskun.

8. VLERËSIMI I RISKUT

Termi “Vlerësim i riskut” i referohet procesit të identifikimit dhe vlerësimit të nivelit të rrezikut në një situatë specifike, duke përdorur një qasje sistematike dhe duke marrë në konsideratë një seri faktorësh. Vlerësimi i riskut duhet të rishikohet në intervalë të rregullt kohor dhe të kryhet nga profesionistë të trajnuar bashkë me viktimën e dhunës¹⁸.

Rasti vlerësohet me risk të lartë nëse gruaja dhe fëmijët e saj janë në rrezik për të qenë subjekt i një dhune të ashpër dhe i rrezikohet jeta, shëndeti dhe liria (*referoju treguesve të riskut në faqen 24*). Risku i lartë nuk është karakteristikë e viktimës por një nivel rreziku i shkaktuar nga dhunuesi.

Niveli i rrezikut nuk është i pandryshueshëm sepse risku është një koncept dinamik dhe në ndryshim. Çdo viktimitë e dhunës mund të gjendet vazhdimisht në situata që çojnë në rritje ose ulje të nivelit të riskut.

Për t'u mbajtur në vëmendje:

Të gjitha nivelet e riskut duhet të menaxhohen, jo vetëm rastet me risk të lartë.

Asistenca duhet të ofrohet për të gjitha viktimat e dhunës pavarësisht llojit dhe nivelit të dhunës së pësuar.

Risku është koncept dinamik dhe mund të ndryshojë vazhdimisht. Për këtë arsye është i nevojshëm vlerësimi i herëpashershëm i nivelit të riskut.

¹⁸ WAVE, “Protect II, Rritje e kapaciteteve për vlerësimin e riskut dhe menaxhimin të sigurisë për të mbrojtur viktimat e dhunës me rrezik të lartë”, Austri, 2012.

Në thelb, vlerësimi i riskut shërben për të vendosur një bazë mbi të cilën rasti do të monitorohet nga punonjësi social i NjVNR.

Siç është përshkruar në seksionin për legjislacionin specifik të NjVNR të këtij udhëzuesi, ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" specifikon detyrat e NjVNR duke u shprehur se kjo njësi kryen "vlerësimin fillestar të riskut". Detyrë tjetër për NjVNR është "mbikëqyrja në vazhdimësi e ecurisë së rasteve". Në këtë pikë evidentohet se ligji ka nevojë për përmirësim pasi parashikohet vetëm kryerja e vlerësimit fillestar të riskut dhe nuk merr në konsideratë faktin që niveli i riskut mund të jetë në ndryshim të vazhdueshëm. Në momentin që punonjësit socialë të NjVNR mbikëqyrin ecurinë e rastit, patjetër që do të vlerësojnë në mënyrë të herëpashershme nivelin e riskut. Situatat ndryshojnë dhe risku mund të përshkallëzohet apo minimizohet me kalimin e kohës.

Shembull: Sara është një vajzë e re 24 vjeçare e cila prej 1 viti bashkëjeton me partnerin e saj. Prej kohësh kishte vërejtur se ai shfaqte shenja xhelozie por kjo gjë nuk e shqetësonte Sarën. Në momentin që filluan të bashkëjetonin, xhelozia e partnerit sa vinte e shtoej dhe madje i kërkonte vazhdimisht të largohej nga puna dhe të mos frekuentonte më shoqërinë e saj. Sara nuk pranonte këto kushte dhe kjo gjë shkaktonte debate të ashpra në çift. Gjatë situatës së fundit të mosmarrëveshjeve të tyre, partneri i saj e dhunon fizikisht dhe Sara telefonon policinë. Policia vlerëson rastin me risk të moderuar, harton kërkesë-padinë për UMM dhe e dorëzon atë në gjykatë. Edhe pse nuk kishte patur episode të mëparshme të dhunës fizike dhe dhunuesi shprehet i penduar në gjykatë, gjykata vendos për lëshimin e UMM dhe detyron partnerin e saj të largohet nga banesa. Rasti fillon të menaxhohet nga punonjësi social i NjVNR dhe, pas pajisjes me UMM, konsiderohet me risk të ulët. 5 ditë pasi Sara ishte pajisur me UMM, partneri i saj i cili nuk pranonte ndarjen, shkon në banesë, e dhunon fizikisht dhe e mban të mbyllur në banesë për 4 ditë. Gjatë këtyre ditëve jo vetëm e dhunon fizikisht por edhe abuzon seksualisht me të. Sara arrin të largohet dhe shkon për të denoncuar dhunën në polici.

Rasti i mësipërm është një rast i marr nga praktika e cila shpesh herë na tregon se dhuna në familje si fenomen kërkon një vëmendje të shtuar kryesisht përsa i përket sigurisë së viktimave. Rreziku për jetën dhe shëndetin e viktimës ekziston gjithmonë, edhe në rastet që fillimisht mendohen si me rrezik të ulët. Pavarësisht vlerësimit fillestar, rekomandohet që çdo rast të monitorohet me rigorozitet dhe të mbahet në vëmendje se niveli i rrezikut mund të ndryshojë edhe brenda pak orëve.


9. HARTIMI I PLANIT INDIVIDUAL TË PËRKUJDESIT DHE MBËSHTETJES

Plani i ndihmës individuale hartohet për çdo rast që mbështetet nga MKR dhe duhet të bazohet në nevojat individuale të rastit siç vlerësohen nga ETN duke përfshirë fushat si siguria, akomodimi afat-gjatë, problemet ligjore, punësimi, mbështetja psiko-sociale, marrëdhëniet familjare, si dhe arsimimi e formimi profesional. Plani i ndihmës individuale formulohet në atë mënyrë që t'u korrespondojë me lehtësi nevojave të identifikuara gjatë procesit të vlerësimit. Një rast mund të ketë nevojë apo të dëshirojë ndihmë pak a shumë në secilën prej këtyre fushave të cituara më sipër, ose vetëm në disa prej tyre. Nëse nuk ka nevojë për ndihmë në një fushë të veçantë ose nëse ndihma e kërkuar në një fushë të caktuar nuk mund t'i jepet gjatë kohës që rasti ndiqet nga MKR përkatëse, atëherë në planin e ndihmës duhet të përfshihet vetëm një shpjegim i shkurtër mbi arsyen përse veprohet në këtë mënyrë. Në planin e ndihmës individuale sugjerohet të përfshihet e detajuar vetëm ndihma që do t'i jepet rastit gjatë kohës që menaxhohet nga anëtarët e MKR përkatëse¹⁹.

Plani i përkujdesit dhe mbështetjes (në disa raste referohet edhe si "plani i ndihmës") është i lidhur ngushtësisht me identifikimin dhe vlerësimin e nevojave. Ashtu si në rastin e vlerësimit të nevojave, edhe plani i përkujdesit dhe mbështetjes hartohet bashkarisht me viktimën e dhunës, respektohet vullneti i saj i lirë në palnifikimin e ndërhyrjes por duke u orientuar nga punonjësi social i NjVNR i cili mban parasysht edhe shërbimet ekzistuese të ofruara në zonën ku viktimë e dhunës banon.

¹⁹ Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), fq. 32.

Plani individual i përkujdesit dhe mbështetjes, duhet të jetë:



10. BASHKËRENDIMI I PUNËS ME AKTORË TË TJERË OFRUES TË SHËRBIMEVE

Komunikimi dhe koordinimi multi-sektorial është një hallkë tjetër e rëndësishme për ofrimin e shërbimeve me efikasitet e lidhur ngushtësisht me identifikimin e nevojave, planin e përkujdesit dhe mbështetjes dhe vlerësimin e riskut. Pas kryerjes së këtyre hapave, punonjësi social i NjVNR duhet të referojë rastin për shërbime të mëtejshme dhe në përshtatje të plotë me nevojat e identifikuara. Për këtë, duhet të ketë një hartë të plotë të shërbimeve të ofruara në zonë, kontaktet e tyre dhe të përditësojë këto kontakte në mënyrë të herëpashershme.

Më poshtë, disa këshilla praktike për referimin e rasteve:

- *vlerësoni se ku mund të referohet rasti për të marrë shërbime të mëtejshme në përputhje me nevojat e saj;*
- *informoni viktimën për shërbimet e ofruara nga institucionet dhe OJF-të që ushtrojnë veprimtarinë në zonë;*
- *respektoni vullnetin e viktimës dhe merrni pëlqimin e saj para se të bëni referimin;*
- *informoni viktimën se cfarë informacioni duhet të ndani me ofruesit e tjerë të shërbimeve ku do të referohet rasti;*
- *ndani vetëm informacionin e nevojshëm për shërbimin e kërkuar me ofruesit e tjerë të shërbimeve ku referoni rastin;*

- *orientoni viktimën që të ndajë informacionin e rëndësishëm me ofruesit e tjerë të shërbimeve sipas specifikës së shërbimit që kërkon;*
- *ndani kontakte dhe informacion të plotë me viktimën lidhur me institucionin apo OJF-në ku referoni rastin. Sqaroni me saktësi adresën;*
- *hartoni një raport të shkruar për referimin e rastit. Sipas nevojës, kontaktoni edhe në telefon me ofruesin e shërbimit ku po e referoni;*
- *evitoni shoqërimin e rastit tek ofruesit e tjerë të shërbimeve. Ju duhet të synoni që ajo të fuqizohet dhe të orientohet për marrjen e shërbimeve pa qenë nevoja e prezencës tuaj.*

11. LITERATURA E PËRDORUR

Marianne Hester, "Kush i bën cfarë kujt? Gjinia dhe dhunuesit në familje në të dhënat e policisë angleze", Gazeta Europiane e Krimnologjisë, vol. 10, Nr. 5, 2013.

INSTAT, "Gratë dhe burrat në Shqipëri", 2021.

Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, Këshilli i Evropës, 2011.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1979.

Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, "Për aderimin në Konventën 'Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave'".

Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave".

Ligji nr. 47/2018, datë 23.7.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Ligji nr. 125, datë 15.10.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, përkrahjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

ESA Consulting/UNICEF, "Udhërrëfyes për bashkitë për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të perkujdesit shoqëror", Mars 2019.

Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

WAVE, "Protect II, Rritje e kapaciteteve për vlerësimin e riskut dhe menaxhimin të sigurisë për të mbrojtur viktimat e dhunës me rrezik të lartë", Austri, 2012.

Protokolli i menaxhimin të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR).